



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NSH Raketa" të datës 06.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NSH Raketa" të datës 06.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1 ashtu që ANULOHE** njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NSH Raketa" (tutje "parashtruesi") me datë 06.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEA dhe nevoja tjera komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1168-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. "Grupi i OE i propozuar për kontratë në oferten e tyre kanë ofruar kontratën e skaduar të njërit nga puntorët e qertifikuar për ngrohje qendrore (Puntori: Enis Canolli) i cili me datën 05.01.2023 ka nënshkruar kontratë pune për periudhë 12 mujore që do të thotë se kjo kontratë ka skaduar më 05.01.2024, kontrata e paraqitur nga grupi i OE nuk është valide. Dëshmia të dokumentet shtesë".

P.2. "Grupi i OE i propozuar për kontratë nuk ka ofruar vlerësim të rriskut për poziten Kamion me Vinq mjeti i cili është kërkuar të kapaciteti teknik dhe profesional. Sipas Ligjit NR. 04/L-161 për sigurin dhe shëndetin në punë neni 5, pika 3 thotë: Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës".

Lidhur me pretendimin 1 është gjetur se ky pretendim është i bazuar prandaj aktiviteti duhet të kthehet në rivlerësim me c'rast komisioni vlerësues duhet të shqyrtoj mundësinë që të kërkoj sqarime shtesë dhe të konfirmoj nëse është përmbushur kërkesa e DT ose jo.

Lidhur me pretendimin 2 është gjetur se ky pretendim është i pabazuar dhe se raporti i vlerësimit është dorëzuar në përputhje me kërkesat e DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.